



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30.07.2018, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i politikave fiskale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci (Bako) - Përgjegjëse sektori, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Alba Çaroshi – Këshilltare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni për sot kemi dekretin e Presidentit të Republikës nr. 10850, datë 30. 07. 2018 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39\2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””.

Relatore e komisionit për këtë projektligj ka qenë zonja Blerina Gjylameti dhe po ajo do të bëj relatimin edhe për dekretin e Presidentit. Për të njëjtën çështje ka ardhur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj. Do të procedojmë me relatimin për këtë çështje nga ana e relatores së komisionit dhe pastaj me qëndrimin e qeverisë në raport me ligjin që është kthyer pas nga Presidenti i Republikës.

Zonja Gjylameti, fjala është për ju.

Blerina Gjylameti – Ta lexoj të gjithë dekretin, apo jo?

Erion Braçe – Dekreti është bërë i njohur për secilin nga deputetët dhe opinionin publik.

Blerina Gjylameti – Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka depozituar pranë Kuvendit dekretin nr. 10850, datë 30. 07. 2018 “Për kthimin e ligjit nr. 39\2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””. Bazuar në nenin 27, pika 7 e Rregullores së Kuvendit, ky dekret është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 86, 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës, pra, shqyrton vetëm çështjet e ngritura për nenin 6 të ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”. Në arsyetimin e tij për kthimin e ligjit Presidenti i Republikës është mbështetur kryesisht në dy elemente, si më poshtë:

Së pari, iniciativa nuk përmbush objektivat sociale të shtetit shqiptar, të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës.

Së dyti, ndryshimet e propozuara janë të paargumentuara nga ana ekonomike dhe kanë sjellë ulje, reduktim të normës të barrës fiskale nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për biznesin e lojërave të fatit. Për të bërë një analizë më të plotë të këtyre pretendimeve, po i analizojmë ato me radhë.

Për sa i përket pretendimit për mospërbushje të objektivave sociale, të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës, vlerësojmë se është i bazuar pasi ligji nr. 39\2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””, nuk ka në fokus dhe nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me asnjë prej objektivave socialë të parashikuar në nenin 59 të Kushtetutës, pasi ky ligj rregullon mënyrën e taksimit të tatimit mbi të ardhurat. Pavarësisht kësaj, në hartimin e tij, siç është evidentuar edhe nga Presidenti, qeveria dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat kanë mbajtur në konsideratë disa elemente specifike që lidhen apo janë në vazhden e të gjitha lehtësirave, politikave dhe objektivave sociale të qeverisë, siç është reduktimi, ulja e normës së tatimit nga 15% në 5% për biznesin e vogël dhe të mesëm, për fermerët që përfshihen në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, si dhe për ato biznese që operojnë në fushën e agroturizmit.

Neni 6 i ligjit nr. 39\2018 synon riformulimin e paragrafit të dytë të nenit 38, dispozita kalimtare, me qëllim saktësimin e përkufizimit të të ardhurave bruto nga lojërat për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, si dhe unifikimin e këtij paragrafi me përcaktimet e tjera të bëra në ligjet e fushës, duke mundësuar zbatimin më mirë të dispozitës dhe për rrjedhojë të ardhura të shtuara në buxhetin e shtetit, të cilat do t'i shërbejnë ndër të tjera edhe realizimit të mëtejshëm të objektivave sociale dhe reformave të ndërmarra aktualisht nga qeveria.

Për sa i përket argumentit të Presidentit se ndryshimet e propozuara janë të paargumentuara nga ana ekonomike dhe se ka ulje, reduktim të barrës fiskale nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për biznesin e lojërave të fatit përmes përdorimit të konceptit të ardhura bruto dhe jo xhiro vjetore, e konsiderojmë atë jo të drejtë për argumentet e mëposhtme:

Rregullimi i marrëdhënieve që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin, si dhe tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave, bëhet nëpërmjet ligjit nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, i cili në nenin 4, germa “gj”, ka përcaktuar se tek të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, përfshihen ndër të tjera edhe të ardhurat nga lojërat e fatit.

Pra, ligji organik, që rregullon tatimin mbi të ardhurat, në frymën e tij ka përcaktuar se bazë e taksueshme është e ardhura dhe jo xhiroja. Ky koncept përbën frymën e ligjit në

tërësinë e tij dhe për të gjitha llojet e aktiviteteve, kështu që në mënyrë të unifikuar dhe në kontekst edhe lojërat e fatit duhet t'i binden këtij rregulli.

Në vijim të argumentit të mësipërm, theksojmë se edhe vetë ligji organik nr. 155\2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, ka të njëjtin qëndrim për normën dhe bazën e taksimit të lojërave të fatit. Kështu, sipas nenit 52, pika 2 e këtij ligji, të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit tatohen në masën 15%, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë, kurse në nenin 4, pika 40 e po këtij ligji, përcaktohet se e ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

Pra, siç qartësisht del nga dispozitat e sipërcituara, ndryshimet sipas nenit 6 të ligjit nr. 39\2018 nuk e kanë ulur nivelin e taksimit për lojërat e fatit. Ky nivel ishte dhe mbetet i njëjtë, 15% mbi të ardhurat bruto.

Në referencë të neneve të sipërcituara të ligjit për lojërat e fatit u shtua në dhjetor të vitit të shkuar paragrafi në pikën 7 të nenit 38 me këtë përmbajtje: “Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit tatohen me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155\2015 “Për lojërat e fatit të Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligjit nr. 95\2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG project”, sh.p.k.”.

Kjo shtesë, që u miratua me ligjin nr. 105\2017 dhe u dekretua më pas nga Presidenti i Republikës me dekret, është e njëjtë në përmbajtje me ndryshimin e bërë në korrik në ligjin nr. 39\2018, objekt shqyrtimi, po në nenin 38, pika 7 nëpërmjet ndryshimit të paragrafit si më poshtë:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52\2 të ligjit nr.155\2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, aplikohet në shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga lojërat për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare, të licencuar sipas ligjit nr. 95\2013.

E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës totale të fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Qëllimi për unifikimin dhe saktësimin e parashikimeve të fundit të kësaj dispozite të bërë me paketën fiskale 2018 në funksion të aplikimit korrekt dhe shmangies së

interpretimeve gjatë zbatimit të saj, është evidentuar në relacionin shoqërues të projektligjit dhe ka qenë gjithashtu objekt i diskutimit edhe në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Për sa më sipër, mendoj se dekreti nr.10850, datë 30. 07 2018 “Për kthimin e ligjit nr. 39\2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar””, nuk qëndron dhe si i tillë nuk mund të miratohet nga komisioni.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Zoti Ministër, ju do të paraqisni qëndrimin e qeverisë për dekretin e Presidentit?

Arben Ahmetaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit komisionit për mundësinë që na dha për të rishprehur qëndrimin e qeverisë jo vetëm për kthimin e ligjit, por edhe qëndrimin tonë për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë dhe një të vërtetë të domosdoshme për ta ndarë me qytetarët.

Është bërë rëndom trend që gjithkush, të gjithë gjithologët, të ditur dhe të pa ditur, jashtë tryezave teknike apo politike, të gjykojnë për çdo gjë. Kuptohet, lojërat e fatit janë një nënsektor sensitiv dhe gjithkush gjen mundësinë për të ndarë me publikun, në mënyrë populiste apo jo, emocionet e veta të ngjyrosura. Qëndrimi i maxhorancës dhe i qeverisë për lojërat e fatit është i prerë dhe do ta verifikoj më poshtë me fakte dhe me aksione.

Së pari, në sqarim të opinionit publik, sepse ju jeni të mirinformuar për çka ka bërë qeveria (unë e dëgjova me vëmendje relatoren), dua të them që nuk ka asnjë ndryshim në ligjin e lojërave të fatit. Është propagandë. Ndryshimet që bëmë në ligjin e të ardhurave kanë dy elemente:

Elementi i parë është që kemi unifikuar standardin. Për të sqaruar qytetarët dhe të gjithë gjithologët, ajo që praktikisht kemi bërë është se mënyra si definohet baza e taksimit në këto lojëra fati ka pasur një përjashtim, Lotarinë Kombëtare. Pra, të gjitha taksoheshin njësoj, kurse Lotaria Kombëtare taksohej ndryshe. Të gjitha taksoheshin 15%, kurse Lotaria Kombëtare taksohej 10%. Çfarë bëmë ne si qeveri? Ne thamë që do të aplikojmë të njëjtin standard për këtë kompani, që është bërë ligj në kohën e Saliut, si koncesion dhe licencë, dhe do t'i ofrojmë të njëjtat standarde, siç taksohen të gjitha kompanitë në Republikën e Shqipërisë.

Erion Braçe – Saliu...

Arben Ahmetaj – Çfarë thotë neni...? Si thatë?

Erion Braçe – Saliu, që thoni, është Sali Berisha, apo jo?

Arben Ahmetaj – Po, Sali Berisha.

Erion Braçe – Në rregull.

Arben Ahmetaj – Një Sali ka, që e ka shkatërruar Shqipërinë, nuk ka dy, të tjerët i kanë dëmet të vogla!

Neni 52 i ligjit “Për lojërat e fatit”, që nuk e prekëm fare, thotë: “Të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit tatohen me 15%, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë”. Por cili është ligj i veçantë për qytetarët? Është Lotaria Kombëtare, e bërë në kohën e Sali Berishës, e cila taksohej 10%. Pra, po flasim për të njëjtin definicion që e marrim nga i gjithë sektori, e aplikojmë edhe për një kompani që ishte trajtuar ndryshe dhe ia rrisim taksën nga 10%, në 15%.

Pra, boloria e llafeve “ia ulën taksën” është një gënjeshtër e atyre që e kanë bërë këtë propagandë për t’u fshehur pas gishtit. Në të njëjtën kohë, neni 4 i ligjit që nuk ka ndryshuar thotë: “E ardhura bruto nga loja...” (ky është neni i ligjit “Për lojërat e fatit”, që nuk ka ndryshuar, që nuk është prekur, pra është një definicion i vendosur në vitin 2015) “...është shuma e mbetur e organizatorit nga diferenca ndërmjet shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre”.

Tani, çfarë bëjmë ne, madje jam shumë i lumtur që kemi mundësi ta shpalosim para shqiptarëve, sepse ky komision është i mirinformuar dhe me një qëndrim shumë të shëndetshëm ndaj kësaj? Ne themi se tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, pra të ligjit që iu referova “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, aplikohet në shkallën 15%, pra jo më në 10%, por 15%, domethënë është rritur (besoj që sipas asaj se “shtatë herë shtatë bëjnë dyzet e dy”, dhjeta këtu nuk është më e madhe sesa pesëmbëdhjeta dhe nuk besoj se ka ndonjë kuptueshmëri andej që pesëmbëdhjeta është më e vogël sesa dhjeta). Pra, aplikohet në shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare, të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013 para zgjedhjeve të vitit 2013.

Edhe një herë, e ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur e organizatorit nga diferenca ndërmjet shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Është *mot a’ mot*, e njëjta gjë. Ja ku është për qytetarët definicioni i ligjit të vitit 2015 i importuar, pa asnjë diferencë, në ligjin “Për të ardhurat”. Kjo sqaron çfarë qëndrimi ka kjo qeveri dhe çfarë qëndrimi kanë gjithologët.

Për sa i përket dekretit, unë besoj se ata, të cilët e kanë këshilluar Presidentin, e kanë këshilluar gabim, sepse po të lexosh ato që thotë Presidenti, po jua citoj: “Për sa më sipër, nga shqyrtimi i ligjit nr. 39/2018 konstatohet se vetëm një dispozitë e tij, më konkretisht neni 6 të ligjit...”, pra i ligjit që iu referova, “...paraqet një problematikë të theksuar, pasi parashikimet e tij realizojnë uljen e barrës fiskale për bizneset që operojnë sot në të gjitha kategoritë e

lojërave të fatit”, kjo gjë nuk është e vërtetë, përkundrazi. Pra, nëse dikush që e ka këshilluar Presidentin natyrshëm, e ka këshilluar gabim; e ka këshilluar me qëllim; e ka këshilluar pa dashje, për shkak të padijes; e kanë këshilluar teknikë; e kanë këshilluar politikanë, ky është një diskutim përtej kësaj tryeze. Por ajo që bën ligji është se rrit ngarkesën fiskale për atë kompani, që ishte e përjashtuar nga definicioni standard dhe nga taksimi prej 15%. Deri dje taksohej me 10%, ndërsa kur ta aprovojmë do të taksohet me 15%. E vetmja gjë që bëri dekreti është se shtyu taksimin me 15%, pra la edhe për disa muaj një taksim prej 10%. Këtë bëri dekreti. Ndaj ne, me rrëzimin e dekretit, do të lejojmë hyrjen në fuqi të 15%-shit të taksimit të ri për këtë kompani.

Thënë kjo, ky është një moment shumë i mirë për të mbajtur qëndrim të drejtpërdrejtë për të gjithë këtë nënsektor.

Tani, këtu kam disa shifra për ta ndarë njëherë e mirë historinë e bolorisë së gjithologëve dhe të gënjeshtres politike se çfarë ka bërë njëra parti dhe çfarë ka bërë tjetra; çfarë ka bërë njëra qeveri dhe çfarë ka bërë tjetra, madje po jua them në retrospektivë: në vitin 2005 të ardhurat personale kanë qenë në 23% të lojtarëve dhe 20% e ka lënë Fatos Nano, ndërkohë që Sali Berisha e çoi në 10%, e përgjysmoi ngarkesën fiskale për lojërat e fatit (e vërteta) dhe u krijuan gati 40 kompani.

Në kohën e Sali Berishës lulëzuan lojërat e fatit, ku nga 20% u taksuan në 10%. Kjo është e vërteta përtej debatit politik, se ne i fusim edhe qytetarët në debatin politik, duke bërë që një pjesë të devijojë me qëllim nga e vërteta. Por e vërteta është se Fatos Nano e ka lënë taksën mbi lojërat e fatit në 20%, ndërsa Sali Berisha e bëri 10%, duke u hequr lojërave të fatit gjysmën e ngarkesave dhe nga ku lulëzuan 40 kompani, të cilat u krijuan nën zhvillimin ekonomik të Sali Berishës për lojërat e fatit. Ky është definicioni; kjo është e vërteta me qytetarët.

Në qoftë se doni t’i certifikoni këto shifra, jam i hapur të nxjerr letra zyrtare, siç kam këto, ku të doni ju: në konferencë shtypi, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në faqen zyrtare të ministrit të Financave, në faqen zyrtare të Kuvendit, në faqen zyrtare të qeverisë për të parë cila është e vërteta me lojërat e fatit.

Për ta mbyllur këtë debat idiot, që bëhet në lidhje me taksimin, Fatos Nano e la 20%, ndërsa Sali Berisha e bëri 10%, duke u krijuar kështu 40 kompani. Sa kompani janë sot? Ma bëni këtë pyetje, por nuk ka rëndësi se ia bëra vetes. Sot janë 20 kompani dhe nuk kemi dhënë asnjë licencë të re, përkundrazi, kemi mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam me qytetarët, sepse deputetët këtu e dinë shumë mirë, se nuk kemi dhënë asnjë licencë të re apo asnjë NIPT të ri!

E vërteta e verifikueshme në kanale zyrtare, po të doni edhe medietike, është se nuk kemi dhënë asnjë licencë të re, por e kemi përgjysmuar nga 40 në 20, numrin e kompanive të lojërave të fatit!

Doni një shifër tjetër? Në vitin 2013 nga lojërat e fatit mblidheshin gjithsej 3,7 miliardë lekë. Do t'ju lutesha edhe juve, si anëtarë të parlamentit, ta fiksojmë këtë shifër dhe, për ta thjeshtësuar, themi se mblidheshin 37 milionë dollarë. Pra, ditën kur Sali Berisha ka lënë zyrën, mblidhte 37 milionë dollarë nga lojërat e fatit, ndërkohë sot mblidhen 5,466 miliardë lekë, që do të thotë, po ta marrim për të thjeshtësuar, 54 milionë dollarë, janë më pak kompani sesa nga zhvillimi ekonomik i lojërave të fatit të Saliut dhe mblidhen gati 45% më shumë, 1,8 miliardë lekë (gati 18 milionë dollarë më shumë sesa mblidhej në zhvillimin ekonomik të lojërave të fatit të Sali Berishës). Kjo është e vërteta e lojërave të fatit!

Po ju tregoj edhe taksimin se si ka ndryshuar.

E para dhe, mbi të gjitha, ne ushtrojmë 15% tatim mbi lojërat e fatit me atë definicion të standardizuar tashmë, pastaj 15% për fituesin, për lojtarin; 15% tatimfitimi korporativ mbi kompaninë, si dhe 5% për çështjet e mira. Pra, a e kuptoni se këtë sektor e kemi trajtuar me shumë kujdes, duke ia rritur ngarkesën fiskale dhe jo duke e kufizuar në ligj? Por do të vij te ky moment.

Tani vijmë te një moment shumë interesant i zbatimit të ligjit, te data 1 janar e vitit 2019. Dua që ta deklaroj për qytetarët, sepse deputetët e dinë shumë mirë, e kemi diskutuar në vazhdimësi, se nuk do të ketë shtyrje të ligjit për sa i përket largimit të kazinove elektronike nga qytetet. Më 1 janar nuk do të ketë më kazino elektronike në qytet, do të largohen nga qyteti dhe këtë vendim e ka marrë kjo maxhorancë, e ka marrë maxhoranca e Partisë Socialiste të Shqipërisë, qeveria e Partisë Socialiste të Shqipërisë! Ajo e ka marrë këtë vendim.

Më 1 janar, dua ta ndaj me qytetarët, ta ndaj edhe me kompanitë, ta ndaj edhe me ju, nuk do të ketë më kazino elektronike në qytete!

Në bazë të ligjit, kazinotë elektronike do të largohen në zona ku me ligj do të lejohet ky aktivitet, që nuk ka lidhje me zonat e urbanizuara. Pra, kazinotë elektronike do të largohen nga qytetet.

E dyta, po në bazë të definicionit të ligjit, do të ushtrohen klauzolat e rrallimit të zyrave të basteve një në 200 metra, pra jo një në 10 metra, një në 15 metra ose një në 30 metra.

Çfarë sfide kemi me këtë sektor? Patjetër që kemi sfida të rëndësishme, madje të paadresuara kurrë.

Jua tregova zhvillimin ekonomik të lojërave të fatit në kohën e Sali Berishës: 40 kompani, taksa nga 20% u përgjysmua në 10%, pra ishte fushë me lule për ata që merreshin me lojëra fati! Ndërsa tani rregullat janë të vendosura me maturi, me vendosmëri dhe sfidën e kemi t'i zbatojnë të gjitha agjencitë ligjzbatuese, flas këtu qoftë për Njësinë e Monitorimit të Lojërave të Fatit, qoftë për Policinë e Shtetit apo edhe për institucione të tjera, si pastrimi i parave, krimi ekonomik e të tjerë. Pra, të gjitha institucionet që merren me evazionin, me luftën kundër pastrimit të parave, me frenimin e këtyre fenomeneve do të jenë të angazhuara të zbatojnë klauzolat e këtij ligji.

Çfarë bëmë ne deri sot? Nga ana procedurale ne kemi filluar një fushatë pastrimi të zonave urbane, që më 1 janar të vitit 2019 bëhet realitet, me gjithë shtyrjen e disa vjetëve më parë.

Së dyti, unifikuam dhe rritëm taksimin.

Së treti, kemi reduktuar numrin e kompanive, por nuk kemi dhënë asnjë leje.

Të dashur qytetarë, nuk kemi dhënë asnjë leje që nga viti 2015, pra nuk është firmosur një leje për lojërat e fatit, zero! Por nga 40, numri i kompanive ka shkuar në 20. Madje nuk kemi ripërtërirë as NIPT-et që, për shkak të xhirove të tyre në rënie (në disa vende), t'u arrihet ripërsërisht në një vend tjetër. Jo, as këtë nuk e kemi bërë. Edhe këtë e kemi ndaluar. Pra, një NIPT që ngordh ekonomikisht në Berat, nuk ripërtërihet në Tiranë. Nuk e kemi bërë as këtë. Pra, zero leje. Kjo është një luftë e hapur.

Pse e kemi bërë këtë? Kryetari i komisionit u referohet mirë lojërave të fatit si një gabim i bërë në vitin 1991, por tani detyra është që t'i kufizojmë dhe t'i reduktojmë. Do të ishte ideale që në atë ditë të kishim filluar me një përjasje komplet të re me lojërat e fatit, por tani është momenti kur përballen dy botë. Debati politik për lojërat e fatit qartësohet këtu. Unë shpresoj që sot të kemi qartësuar për qytetarët se çfarë ka bërë një forcë politike dhe se çfarë ka bërë një forcë tjetër politike. Të vërtetat me shifra, me nene, me ligje dhe me fakte dhe me qëndrime politike po deshët.

Unë besoj se me këto masa që po marrim, me atë regjim të ri që do të fillojë më 1 janar 2019, ne do të ndihmojmë gjithmonë e më shumë reduktimin e këtij fenomeni dhe influencën negative sociale që ka te shumë familje dhe të kemi mundësi që edhe nëpërmjet platformës së re teknologjike, që është bërë për monitorimin e lojërave të fatit, ta monitorojmë më mirë këtë sektor dhe të mbledhim më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit.

Unë po e mbyll këtë. Nëse ka ndonjë pyetje, jam gati. Ju them se kemi bërë gjënë e duhur dhe se kemi nevojë të bëjmë shumë më tepër kundër përhapjes së këtij fenomeni. Ato që po bëjmë duke filluar me këto ndryshime dhe me ato procedura më 1 janar, do të shkojmë në kahun e duhur.

Kemi nevojë të mbështetemi edhe nga qytetarët. Patjetër, agjencitë ligjzbatuese kanë detyra shumë të rëndësishme kundër evazionit, kundër pastrimit të parave dhe kundër përhapjes së fenomenit. Ne kemi nevojë që edhe qytetarët të na mbështesim dhe të na ndihmojnë.

Largimi nga qendrat urbane i kësaj veprimtarie mendoj personalisht se do ta reduktojë fenomenin, si një problem shoqëror për shumë familje.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi - Faleminderit, zoti Ministër, për prezencën tuaj dhe për të gjitha sqarimet dhe statistikën që i ofruat komisionit dhe opinionit publik!

Unë kisha përgatitur shumë pyetje, por meqë pjesa më e madhe e tyre morën përgjigje gjatë fjalës suaj, jemi shumë të qartë në lidhje edhe me ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, edhe me ligjin për lojërat e fatit, edhe me përgjigjet ndaj dekretit të Presidentit.

Unë do të fokusohem vetëm në dy pika.

E para, jemi të gjithë dakord që sektori i lojërave të fatit është një sektor shumë delikat që ndër vite ka pasur problematika të mëdha sociale, duke filluar që nga dhuna në familje, konfliktet në familje, divorcet e kështu me radhë. Për këtë arsye unë desha të di diçka në lidhje me informalitetin. Ju e shpjeguat shumë mirë se është ulur ndjeshëm numri i subjekteve të lojërave të fatit. A mendoni ju se është luftuar plotësisht informaliteti? A kemi sot që flasim, subjekte që mund të operojnë në të zezë, sepse situata që ne gjetëm ishte e tillë që në çdo cep pallati dhe lagjeje kishte një subjekt të lojërave të fatit. U ndërmor një fushatë shumë e thellë që në fillim në të gjithë Shqipërinë. Sot që flasim, a ka akoma, apo jo?

E dyta, meqenëse në janar 2019 fillon zbatimi i ligjit në të gjitha pikat e tij (e kam fjalën për ligjin për lojërat e fatit). A do të ketë vështirësi zbatimi i këtij ligji? Ju e përmendët se një nga pikat e këtij ligji është që në çdo 200 metra, do të ketë një pikë lojërash fati. Nuk do të ketë më as 2, as 3, as 4, as 10, siç mund të jenë sot. A do të garantohen kritere të përcaktuara qartë se si do të përzgjidhet ai subjekt nga këto 4 apo nga

10 subjekte? Mund të ketë 2-3-4 subjekte, që operojnë në kushte të ngjashme. Cili do të jetë ai subjekt, që do të rezistojë? Pra, a do të ketë kritere të qarta? Kjo mund të ishte një pikë që shkaktonte abuzivitet dhe korrupsion.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Për sa i përket luftës kundër evazionit në këtë sektor, dua të ndaj me ju se para 2 muajsh e gjysmë ka dalë një urdhër i Kryeministrit për të dy ministrat për të bërë një fushatë të thellë, të përbashkët me Policinë e Shtetit dhe me institucionet tatimore kundër evazionit në këtë sektor. A ka më evazion në këtë sektor? Besoj se ka akoma shumë për të bërë në këtë drejtim. Ky është sektor specifik, që ka rezultuar i vështirë ndër vite.

Unë besoj se reduktimi i kompanive, rritja e taksimit, lufta e ashpër kundër evazionit si në vitin 2014, edhe në këtë vit së bashku me MB-në (nuk besoj se i kemi bërë ndonjë fanfarë betejës, por beteja në terren ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë e ashpër).

Unë mendoj se proceduralisht, pra ato që do të bëjmë, si largimi i kazinove elektronike nga qendrat e banuara, duke ecur me logjikën që vetëm brenda hoteleve me 5 yje do të lejohen licenca, siç e kemi ligjin për të promovuar kthimin e investimit në hotelet me 5 yje, ndërsa çdo kazino elektronike, në rrugë, siç iu referuat edhe ju (në çdo cep pallati), të gjitha do të dalin jashtë qyteteve. Praktikisht, do të kemi çlirimin e qyteteve nga ky fenomen. Ka akoma shumë për të bërë.

Për sa i përket standardit, ai është shprehur qartë në ligj dhe nuk kemi nevojë të shpikim një standard të ri. Standardi është në ligj dhe atë do të zbatojmë. Ai është një standard transparent dhe i drejtpërdrejtë. E rëndësishme është t'i lajmërojmë sot kompanitë dhe qytetarët, se më 1 janar nuk do të operojnë më në qendër apo në zonën urbane të Tiranës, as në zonën urbane të Durrësit. Po ashtu, as në Fier, në Gjirokastrë, në Shkodër, në Korçë dhe në të gjithë Shqipërinë, por do të operojnë jashtë qyteteve. Pra, ka filluar fushata e pastrimit të qyteteve nga ky fenomen.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Unë e mora fjalën për një arsye të thjeshtë. Unë jam plotësisht i qartë për ligjin për lojërat e fatit, që kemi miratuar në vitin 2015, edhe me ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, por sapo lexova një titull në një portal, ku thuhej: “Ministri Ahmetaj mbron lojërat e fatit”.

Edhe një herë, dua të theksoj se kjo që po diskutojmë sot, qëndrimi që po mbajmë në lidhje me dekretin e Presidentit, është për të rritur tatimin mbi lojërat e fatit dhe në mënyrë të veçantë, për Llotarinë Kombëtare. Ne nuk po i mbrojmë lojërat e fatit dhe besoj se edhe ju e shprehët shumë qartë këtë qëndrim. Megjithatë, ta theksojmë fort, që të mos abuzohet me këto lloj rrjetesh duke menduar se rrëzimi i dekretit të Presidentit mbron lojërat e fatit. Është krejt e kundërta, apo jo?

Arben Ahmetaj - Zoti Pëllumbi,

Edhe në nder të mbiemrit që mbani, edhe të traditës familjare që sillni në PS, unë nuk merrem me portalet, sepse portalet këtë punë kanë. Ato duan klikime. Unë merrem me detyrën. Kryetari i komisionit merret me detyrën. Ju këtu, deputetët, merreni me detyrën.

Portalet thonë një gjë, ndërsa unë po them specifikisht para qytetarëve se po fillojmë pastrimin e qyteteve nga ky fenomen. U kemi rritur taksimin. Fatos Nano e la me 20%, Saliu e bëri 10%, ndërsa ne po i nxjerrim jashtë qyteteve.

Kur i nxjerr jashtë qyteteve, kur ua rrit taksën dhe u rrit presionin për ligjzbatueshmërinë, nëse kjo quhet mbrojtje, atëherë portali ka fjalor tjetër, të cilin s'dua ta di.

Ju lutem, mos na sillni portale!

Erion Braçe – Kjo tregon se në çfarë niveli është kapur media në këtë vend.

Ka pyetje të tjera?

Zoti Ministër, kam unë disa pyetje.

Së pari, për ta qartësuar faktin që ju theksuat disa herë se nga 1 janari 2019, lojërat elektronike të fatit do të largohen nga zonat urbane. Kjo nënkupton se do të largohen nga zonat rurale, por që praktikisht janë urbane për shkak të popullsisë që jeton aty, apo jo? Po krijohet perceptimi se do të largohen nga qyteti dhe do të shkojnë në fshat. Dua të jemi sa më të qartë, që të mos dalë tani një tjetër medie dhe të thotë se i hoqi nga qyteti dhe i çoi në fshat.

Ju lutem!

Arben Ahmetaj – Ju falënderoj për pyetjen, se më jepni mundësi ta sqaroj më tej!

Ne fshatin dhe qytetin i quajmë zona urbane. Jo, do të jenë jashtë zonave të banuara në territoret e dizenuara për këtë punë. Larg, sa më larg.

Erion Braçe – Dakord, jam shumë i qartë.

Pyetja e dytë, lidhet përsëri me këtë çështje. A keni marrë ndonjë masë administrative në kuadër të agjencisë që merret me menaxhimin e lojërave të fatit për t'i njoftuar të gjitha subjektet që më 1 janar 2019 do të mbyllet kjo histori dhe që do t'u duhet të gjejnë tjetër

vend për të ushtruar aktivitetin e tyre dhe do të mbyllen në mënyrë vullnetare apo me forcë, edhe këto që janë 100 m larg nga Kuvendi, edhe të gjitha subjektet me radhë në të gjithë territorin e banuar nga qytetarët shqiptarë?

Po më vijnë çdo ditë shprehje të këtij lloji: “Do ta gjejnë gjuhën me politikën edhe këtë herë”. Më intereson shumë të di nëse keni ndërmarrë ndonjë proces për t’i informuar dhe për t’ua bërë të qartë që më 1 janar do të largohen nga aty ku janë.

Arben Ahmetaj - I nderuar kryetar,

Më 1 janar, kazinotë elektronike do të largohen nga qendrat e banuara, ku u referohemi edhe fshatrave, edhe qyteteve. Nuk ka asnjë kthim mbrapa. Kjo ka filluar me urdhër të Kryeministrit, në referencë të ligjit për pastrimin e zonave të banuara nga lojërat e fatit. Kjo nuk diskutohet dhe nuk ka kthim mbrapa.

Ne do të bëjmë punën tonë për t’i informuar. Ligji në vetvete është një informim, por edhe mbledhja e sotme, ku gjithashtu po e ndajmë me qytetarët, është një informim. Jam i bindur se edhe kompanitë e kanë dëgjuar. Në muajt në vazhdim do të kemi të gjithë komunikimin nëpërmjet kanaleve zyrtare për të informuar të gjitha grupet e interesit se çfarë do të ndodhë konkretisht me largimin e subjekteve të tilla jashtë zonave të banuara dhe do të zbatohet distanca prej 200 metrash për bastet sportive

Erion Braçe – Edhe pyetja e tretë, lidhet përsëri me këtë. Ligji do të zbatohet më 1 janar 2019 dhe këto subjekte do të largohen. A keni parashikuar ndonjë masë, që këto aktivitete të mos kthehen në aktivitete ilegale, pas dyqaneve të bukës, të mishit, të bulmetit, pas restoranteve, pas moteleve e kështu me radhë?

A ka ndonjë bashkërendim me agjencitë ligjzbatuese për të parandaluar që nga data 1 janar, që këto aktivitete të largohen realisht nga aty ku janë dhe jo të fillojnë të maskohen dhe ta vazhdojnë aktivitetin pas ndonjë kartonxhesi, aty ku shitet akullorja?

Arben Ahmetaj - Ligji e ka shumë të qartë përgjigjen ndaj evazionistëve. Çdo kompani apo individ që do të aplikojë diçka të kësaj natyre, në kundërshtim me ligjin, si ju e referuat, do të konsiderohet në bazë të referencave ligjore. Agjencitë ligjzbatuese, ku përfshihet edhe Policia e Shtetit, sepse jemi në diskutim edhe me ministrin e Brendshëm, patjetër që do të ketë reagim jashtëzakonisht shumë të fortë. Qytetet do të pastrohen nga ky fenomen. Zonat e banuara do të pastrohen nga ky fenomen. Jo vetëm u rritëm taksën, jo vetëm i reduktuam në numër, por po i largojmë nga qendrat e banuara.

Erion Braçe – Faleminderit!

Kalojmë te kategoria tjetër e lojërave të fatit, që ka të bëjë me bastet sportive.

Zoti Ministër, në fakt, ju keni të drejtë kur thoni të jenë 200 metra larg në vijë ajrore nga njëra-tjetra. Ky ishte kufizimi që miratoi edhe ky komision në vitin 2015, por në seancën plenare ndryshuan gjërat dhe u bë nga 200 metra në 100 metra vijë ajrore. Po të bëjmë një verifikim të lirë fizik në njësinë ku përfshihet edhe Kuvendi, pa më të voglin dyshim që kjo distancë nuk respektohet. A do të ketë ndonjë plan të agjencisë respektive apo të agjencive të tjera ligjzbatuese për të vendosur deri në fund zbatimin e ligjit edhe në fushën e basteve sportive, pra, distanca 100 metra, që është këtu, është minimale për mua, me qëllim që të shkojmë në zbatueshmërinë e qartë të ligjit edhe për këtë pikë?

Arben Ahmetaj – E njëjta gjë që thashë pak më parë vlen edhe për këtë pikë.

Erion Braçe – Në rregull, por kanë kaluar 2 vjet dhe kjo nuk është zbatuar.

Arben Ahmetaj – Se u shty i gjithë ligji. Domethënë, shtyrja e ligjit ua lidhi duart njësisë dhe agjencive ligjzbatuese. Është e njëjta gjë siç thashë për kazinotë elektronike, si referencë ligjore, pra distancimi nga shkolla, nga Kuvendi, 100 metër do të zbatohet me përpikëri dhe me forcën e ligjit. Do të nxjerrim aktin e pikës zero, pra ku fillon numërimi i 100-metërshit. Në referencë të logjikës së pagesës do të jetë kilometri zero i Tiranës, ku edhe do të fillojë numërimi. Kilometri zero mund të jetë sheshi “Skënderbej”, mund të jetë...

Erion Braçe – Bashkia e Tiranës...

Arben Ahmetaj – ...Bashkia e Tiranës. Pra, nuk e dimë dhe po mendojmë për këtë pikë, ku edhe do të fillojë distancimi me një 100 metra.

Erion Braçe – Gjithnjë më synimin për ta kufizuar sa më shumë këtë aktivitet. Në këtë akt a do të ketë edhe një përcaktim të sipërfaqes që duhet të kenë sallat e këtyre basteve dhe të aktivitetit tjetër që i shoqëron, sepse, të them drejtën, në një apartament në pallatet e para vitit '90, 68 metra katrorë, një dhomë apo një ballkon, pikërisht brenda këtij aktiviteti ngatërrohen dy të tilla, edhe kafeneja, edhe qebapi, edhe basti? Kjo të behet me qëllim që kjo histori të kufizohet edhe më tej.

Arben Ahmetaj – Patjetër që do të ketë referenca. Ditën kur do të kemi gati formatin e udhëzimit, do ta konsultoj edhe me këtë komision. Në qoftë se do të ketë ndonjë koment, ndonjë opinion, ndryshim apo përmirësim, ta bëjmë bashkë dhe pastaj ta nxjerrim si udhëzim, meqë është kthyer në një çështje të debatit publik.

Erion Braçe – Pyetja tjetër. Ligji përmban kufizime për reklamën e këtyre aktivitetëve, ka kufizime për fasadën e tyre, që, keq më vjen, por nuk është zbatuar (ju thashë 100 metra nga këtu, është një faqe tërë, kufizime ka edhe për reklamën në mediet elektronike apo edhe në medien e shkruar. Për fat të keq, gjatë të gjitha ditëve të Kampionatit Botëror ky ligj është dhunuar brutalisht. Jo vetëm që nuk janë respektuar këto gjëra, por u sajuan

emisione të tëra që nuk ishin sportive, por emisione basti, të cilat i nxisnin qytetarët nga televizioni për t'u bërë pjesë e basteve për ndeshjet e Kampionatit Botëror. Këto emisione vazhdojnë edhe sot që flasim. Natyrisht, e kemi pranuar botërisht që qeveria nuk duhet të ndërhyjë në medie, por të paktën a mundet që ju të detyroni autoritetin respektiv, AMA-n, të merret pikërisht me këtë çështje?

Arben Ahmetaj – Keni shumë të drejtë, kryetar. Fakti që gjatë Kampionatit Botëror u dha rëndom reklama e lojërave të fatit, tregoi edhe një herë betejën e vështirë që kemi dhe do të kemi me këtë nënsektor. Është e papranueshme që televizione kombëtare dhe jokombëtare, megjithëse ligji e shpreh qartë, kanë pranuar reklama për bastet sportive. Besoj se në të gjithë betejën që kemi me këtë antiformalitet për rregullimin e nënsektorit, patjetër që AMA ka shumë për të bërë, por edhe vetë televizionet do të duhet të ndërgjegjësohen. Ju e dini shumë mirë, sepse ne e kemi diskuar këtu, që nuk ka sukses në botë në mbledhjen e taksave apo rregullim i këtyre sektorëve me dhunë, por është edhe çështje e edukimit të tatimpaguesit apo i të gjithë aktorëve, në rastin konkret i televizioneve, apo i AMA-s, nëse doni. Kemi vënë gjoba për të gjithë. Ministria e Financave nuk është një institucion dhune; tatimet po ashtu; njësia e monitorimit të lojërave të fatit nuk është një institucion dhune që t'i bjerë derës me shkelma, të futet e të marrë televizorin e ta hedhë në tokë. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka institucione të kësaj natyre. Nuk ka sukses në mbledhjen e taksave nëse prevalon dhuna. Edukimi i tatimpaguesve besoj se është një domosdoshmëri; në këtë rast edhe edukimi i televizioneve. Gjobat janë vënë, kryetar. Mbetemi të hapur për ndonjë sugjerim nga ana juaj për ta përmirësuar këtë betejë. Kjo gjë nuk diskutohet. Ta kufizojmë edhe përtej asaj që kemi bërë deri tani. Unë jam i hapur dhe jam pro kësaj.

Erion Braçe – Kam edhe dy pyetje të fundi, zoti Ministër!

A mund të më thoni se sa ka qenë xhiroja vjetore, ose qarkullimi vjetor për vitin 2017 i të gjitha kompanive të lojërave të fatit, duke përfshirë edhe ato elektronike, e të basteve sportive dhe sa është fitimi i realizuar prej tyre?

Arben Ahmetaj – Unë jua thashë të gjithë xhiron në vitin 2017. Në vitin 2016 ka qenë 4, 8 miliardë...

Erion Braçe – Ky që thatë është tatimfitimi.

Arben Ahmetaj – Më fal, janë të ardhurat. Nuk është vetëm tatimfitimi, por është totalin i taksave që numërova unë.

Erion Braçe – Pra, të gjitha se çfarë u është marrë. Mua më intereson xhiroja.

Arben Ahmetaj – Xhiron do t'jua dërgoj zyrtarisht me shkresë, po deshët, të ndarë për të gjitha kompanitë.

Erion Braçe – Do të jetë një gjë e mirë që ne ta disponojmë këtë gjë.

Arben Ahmetaj – Gjatë ditëve që do të vijën do t'ju dërgoj të gjithë listën e kompanive dhe të gjitha xhirot e deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve edhe nëpërmjet platformës elektronike.

Erion Braçe – A keni në plan të rishikoni ligjin për lojërat e fatit?

Arben Ahmetaj – Kryetar, në të vetmin rast që do të rishikonim ligjin e lojërave të fatit, do të ishte rritja e mëtejshme e taksimit. Vetëm në këtë rast do ta rishikonim ligjin e lojërave të fatit.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka diskutime?

Po, zonja Gjylameti ka një diskutim.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Pikë së pari unë mendoj se duhet të vazhdojmë të theksojmë se ligji i ndryshuar për tatimin mbi të ardhurat synimin bazë nuk e ka pasur absolutisht, dhe nuk është absolutisht e vërtetë, uljen e tatimit të lojërave të fatit, por, mbi të gjitha, uljen nga 15%-5% për agroturizmin, biznesin e vogël, për biznesin e mesëm dhe për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Kështu që kjo duhet të theksohet, sepse besoj se ka nevojë që herë pas herë ne të kujtojmë, mbi të gjitha, të informojmë edhe publikun se cili është synimi i ndryshimit të këtij projektligji. Ndërkohë, ai ndryshim që është bërë në nenin 6, pikërisht për standardizimin e të gjitha lojërave të fatit, duke përfshirë këtu edhe Lotarinë Kombëtare, e cila nëse më parë ishte me 10%, sot kalon në 15%. Mendoj se ajo që duhet të theksohet është fakti, zoti Ministër, se sot, fatkeqësisht, nuk kemi probleme të ligjit apo të dispozitave të tij, por të zbatueshmërisë së tij. Mendoj se nga ana juaj do të duhet të kemi një intensifikim të punës për monitorimin e të gjitha agjencive ligjzbatuese që rregullojnë apo monitorojnë lojërat e fatit. Ende sot ne flasim për informalitet. Do të duhej të ketë intensifikim pikërisht për të ulur informalitetin. Kryetari i komisionit ngriti shqetësimin e kalimit në ilegalitet të disa prej tyre, të cilat do të mbyllën. Edhe sot ne kemi nga ato që funksionojnë në ilegalitet. Ndaj, besoj se do të duhet të bëjmë pikërisht atë që diskutuat: të ulemi e të punojmë për intensifikimin e punës së agjencive ligjzbatuese. Sot ne kemi të ardhura nga lojërat e fatit. Do të duhet të jenë sa më pak informale, pra që të kalojnë te buxheti i shtetit, pavarësisht se është një nga plagët e shoqërisë shqiptare. Mendoj se tek udhëzimi që do të sillni duhet të jeni shumë specifikë për sa u përket kriterëve. Nuk është vetëm fakti i afërsisë apo i largësisë, por janë edhe kriteret që duhen zbatuar apo duhen monitoruar nga agjencitë, siç është mosha e atyre që luajnë.

Një tjetër shqetësim që kam, besoj se është i të gjithëve, janë lojërat e fatit online, të cilat mendoj se sot do të duhet të monitorohen shumë më tepër, pasi nëse diskutojmë që afërsia apo largësia nga një pikë basti nxit edhe ata që janë nën 18 vjeç të luajnë, ata që kemi online e kemi shumë të vështirë t'i kontrollojmë. Kështu që edhe këtu do të duhet të kemi një vëmendje të posaçme. Një gjë tjetër që do të doja ta shikonim më vëmendje të posaçme është që duhet të përgatiten të gjitha agjencitë. 1-janari është shumë afër dhe nuk duhet të dështojmë edhe një herë tjetër, sepse, siç e thatë edhe ju kemi punuar ndër vite për të ndryshuar dhe për të përmirësuar pikërisht përgjigjen ndaj kësaj plage të shoqërisë. Gjatë këtyre tre muajve duhet të punojmë shumë më tepër që të arrijmë që në datën 1 janar të bëjmë të mundur hyrjen në fuqi të ligjit për lojërat e fatit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Zonja Gjylameti, më dhatë mundësinë të bëj edhe një shpjegim tjetër. Jam i bindur se do të kemi vështirësi, por nuk do të dështojmë. Nuk ka tërheqje mbrapa. Urdhri i Kryeministrit është të zbatohet ligji një për një dhe më 1 janar të gjitha kazinotë elektronike të dalin jashtë zonave të banuara. A do të jetë e vështirë?! Çdo proces ka vështirësinë e tij. Ne jemi të bindur që nuk ka hap mbrapa dhe agjencitë ligjzbatuese e kanë shumë të qartë dhe sektori po ashtu.

Edhe për ju si anëtarë të parlamentit duhet të sqaroj një element shumë interesant. Kanë pretenduar që Lotaria Kombëtare paska pasur të drejtë të trajtohet ndryshe me ligj. Gjej rastin të shpreh që edhe Lotaria Kombëtare, në të drejtën e kazinosë elektronike që quhet VLT, nuk do të jetë në zonë të banuar. Nuk ka përjashtim për asnjë kompani. Jo ligji i veçantë, jo ashtu. Ligji është i vitit 2015, e ka votuar parlamenti, e ka vendosur sovrani. Nuk ka përjashtime për asnjë kompani, zero. Ne nuk bëjmë përjashtime për kompanitë e prodhimit të bukës, bëkemi tani përjashtim për Lotarinë Kombëtare! Zero! Nuk ka.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Për ta mbyllur, zoti Ministër, unë doja të thosha disa fjalë.

Së pari, është shumë e rëndësishme të theksoj atë që është fare e evidente. Dekreti i Presidentit fizikisht është i vërtetë, në përmbajtje është thelbësisht i rremë për disa arsye.

Së pari, mbi të gjitha, ligji për të tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, i cili është miratuar në këtë komision dhe në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nuk ka të bëjë me lojërat e fatit. Ligji, në mënyrë të qartë, ka të bëjë me uljen e tatimit për bizneset e vogla

dhe të mesme, me xhiro deri në 140 milionë lekë në vit, nga 15% në vetëm 5%. Nga data 1 janar të gjitha këto biznese do të marrin përfitimin fiskal që kjo maxhorancë ka kryer.

Së dyti, ligji ka pasur në fokus të tij agroturizmin dhe që nga data 1 janar këto biznese do të favorizohen haptazi në veprimtarinë e tyre përmes favorit fiskal që kjo maxhorancë u ka dhënë me këtë ligj të posaçëm.

Së treti, ligji ka pasur në fokus të veçantë kooperimin, me qëllim rritjen e produktivitetit në bujqësi dhe në blegtori. Pra, ka pasur në fokus të qartë fshatin, duke favorizuar këto aktivitete me uljen e tatimit nga 15% në 5%. Ky është thelbi i ligjit dhe pikërisht për këtë arsye më duhet ta përsëris edhe një herë që dekreti i Presidentit fizikisht është i vërtetë dhe ekziston, por në përmbajtje është i rremë, edhe për një arsye të dytë shumë të qartë, sepse Presidenti i Republikës pretendon se ne kemi ulur normën e tatimit për lojërat e fatit, gjë që rezulton thelbësisht e pavërtetë. Nuk ka ulje të normës së tatimit për lojërat e fatit, për më tepër ky definicion i vendosur në ligjin për tatimin mbi të ardhurat nga ne është i njëjtë me atë të vendosur në ligjin për lojërat e fatit në vitin 2015. Më lejoni t'ju them në mënyrë të qartë se për Lotarinë Kombëtare ka rritje të normës së tatimit për të ardhurat e realizuara pikërisht nga ai aktivitet dhe mbi të gjitha për të bërë një apel për ta larguar propagandën nga marrëdhënie, të cilat, në rastin e ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale janë thelbësisht teknike. Dua të theksoj se në vitin 2015 Presidenti i Republikës ka votuar të njëjtin definicion, me zë, me figurë dhe me gisht në makinën që ka pasur përpara për të materializuar votimin e tij.

Duke i thënë të gjitha këto, pa asnjë lloj diskutimi që dekreti i Presidentit ka një vlerë, pse jo për të nxitur edhe më tej diskutimin për lojërat e fatit në këtë vend. Ky është një proces që e kemi pasur pothuajse gjatë gjithë kohës në vëmendje dhe ky komision e ka pasur në qendër të punës së tij. Për këtë arsye dua të falënderoj ministrin, Ministrinë e Financave dhe njësinë për mbikëqyrjen e lojërave të fatit, jo vetëm për informimin e vijueshëm të këtij komisioni lidhur me këtë çështje, por edhe për punën e kryer deri tani, qoftë në legalizim, qoftë edhe në reduktim të lojërave të fatit.

Është evident fakti i verifikuar dhe i kontrolluar, që nuk ka një licencë të re në lojërat elektronike të fatit apo edhe në bastet sportive dhe kjo ka ndodhur që nga viti 2015 e këtej, ashtu siç është evident edhe fakti tjetër që kudo ku mbyllet një pikë basti nuk është lejuar të hapet një e re. Ka probleme, por pa asnjë lloj diskutimi që ka probleme në menaxhimin e këtij sektori, që, për fat të keq, administrohet në mënyrën më të shkëlqyer të mundshme vesin e kujtdo duke e kthyer në fitime për ta dhe në probleme të mëdha sociale për të gjithë shoqërinë shqiptare.

Dua ta përsëris se e gjitha është bërë gabim që në vitin 1991. Hapja e Shqipërisë dhe kalimi në sistem tjetër natyrisht që u bë pa fre, pa kontroll dhe duke e lënë këtë sektor në duar thelbësisht të privatit, të interesuar thjesht për fitim. E di që ka një debat se sa duhet të ndërhyjë shteti në këtë histori, sa duhet të kontrollojë shteti dhe këtu ndahemi në komunistë, në sovranistë të djathtë, populistë apo çfarë quhen. Më lejoni t'ju referoj shembullin e Gjermanisë, e cila 60% të këtij sektori e kontrollon në mënyrë publike, e ka kthyer në monopol shteti dhe ka qenë Gjykata Kushtetuese që ka mbrojtur vendimin e autoriteteve politike për ta pasur këtë sektor nën kontroll përmes monopolit shtetëror. A është koha të kthehemi pas dhe ta zgjidhim në këtë mënyrë?! Unë nuk e di, prandaj ju pyeta nëse ne do të shkojmë drejt rishikimit të këtij ligji apo jo, por, nëse kjo ndodh, unë mendoj se shembulli i Gjermanisë vlen në mënyrë thelbësore.

Në krahun tjetër, zoti Ministër, pa asnjë lloj diskutimi që normat e fitimit në këtë sektor, më lejoni ta them kështu, janë të paturpshme. Kam disa të dhëna, që u referohen viteve që kanë kaluar dhe që kanë të bëjnë me qarkullimin vjetor të këtyre kompanive, kryesisht lojërave elektronike të fatit dhe fitimet e realizuara. Në 20 kompanitë e para është vetëm një e tillë, e 19-a, ku norma e fitimit të kësaj është 39%, duke vijuar me 31 kompanitë e para shtohet edhe një e dytë, ku norma e fitimit të saj është 32%, për të vijuar me 46 kompanitë e para shtohet edhe një tjetër dhe norma e fitimit të saj është ajo që sapo përmendet ju, e cila arrin në 50%. Në 49 kompanitë e para shtohet edhe një tjetër dhe norma e fitimit të saj është 21%. Në 52 kompanitë e para kemi 5 kompani, që merren drejtpërdrejt me lojërat elektronike të fatit. Është edhe e pesta dhe ka një normë fitimi 32%. Në rast se do të materializohet rishikimi i ligjit për lojërat e fatit, me norma të tilla fitimi, pa asnjë lloj diskutimi, mua më takon ta mbështes iniciativën tuaj dhe, mbi të gjitha, të rishikohet norma e taksimit të tyre.

Unë kam një qëndrim të qartë në këtë aspekt, tatimi progresiv mbi të ardhurat nga kapitali duhet të shkojnë më tutje dhe tatimi progresiv mbi të ardhurat nga lojërat e fatit, pa asnjë lloj diskutimi, duhet të shkojë në nivelin lart deri në masën 50%. Thënë këtë, dua të konfirmoj edhe një herë faktin që kjo maxhorancë në të gjitha kohërat ka pasur një qëndrim shumë të qartë kundrejt të ardhurave nga lojërat e fatit. E konfirmoj atë që tha ministri, që jemi larguar nga pushteti në vitin 2005 me 23% tatim fitimi për organizatorin e lojërave të fatit dhe në 20% tatim mbi të ardhurat personale për lojtarët. Në vitin 2006, ata që erdhën në pushtet, e bënë zero tatim fitimin për lojtarët dhe 20% tatimin mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit. Në vitin 2008, kur zbuluan ideologjinë e tatimit apo taksës së sheshtë, u çmendën dhe mbajtën zero tatimin për të ardhurat e individëve lojtarë dhe bënë 10% tatimin

mbi fitimin për organizatorin. Pikërisht në këtë vit, kërcimi, mund t'jua jap treguesit, i numrit të kompanive të lojërave elektronike të fatit dhe i kompanive të basteve sportive është spektakolar. Në vitet 2009-2013, përfshirë edhe vitet e krizës, kur shqiptarët nuk kishin para, tatimi ka qenë në këto norma, 0 për lojtarët dhe 10% për kompanitë e lojërave të fatit dhe të basteve sportive. Në vitin 2014, sapo erdhëm ne në pushtet, kemi bërë tatimin mbi fitimin për organizatorët e lojërave të fatit 15%, e kemi konfirmuar në vitin 2015 në ligjin e ri dhe kemi hedhur hapin tjetër, ku kemi tatuar me 15% të ardhurat e lojtarëve fitues dhe kjo normë mbahet edhe sot, shoqëruar me një aksion të tërë të përditshëm të legalizimit të lojërave të fatit atje ku ishin të paligjshme dhe, natyrisht, të reduktimit të lojërave të fatit atje ku kanë ushtruar aktivitetin e tyre në mënyrë të ligjshme. Kjo është vërteta dhe kjo e vërtetë kërcet. Kush do të bëjë propagandë, le të bëjë, pa asnjë problem, por me këtë komision nuk e bën dot, sepse këtu të dhënat janë shumë të qarta, përditësohen kohë pas kohe dhe bëjnë të mundur që të gjithë deputetët e këtij komisioni të jenë të qartë, konkretë dhe profesionalë në atë që është e vërtetë dhe që çmonton thelbësisht propagandën.

Në fund, po e përsëris edhe një herë, unë dua të vlerësoj punën e kryer nga të gjitha agjencitë ligjzbatuese deri tani, përfshirë Ministrinë e Financave, njësinë e mbikëqyrjes së lojërave të afatit, njësinë e parandalimit të pastrimit të parave dhe agjencitë tjera, që kanë apo janë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Brendshme e kështu më radhë, por dua të vë theksin pikërisht tek tendenca gjithnjë e më e fortë e krimit të organizuar për të hyrë apo për t'u konsoliduar brenda këtij aktiviteti, që do të thotë se kjo kërkon një angazhim edhe më të madh të të gjitha strukturave ligjzbatuese të shtetit për të goditur të dy fenomenet, edhe krimin e organizuar, edhe lojërat e fatit.

Në krahun tjetër, dua të vë theksin në zbatimin me forcë të këtij ligji për sa u përket masave kufizuese që janë vendosur në të, përfshirë largësinë, përfshirë moshën e lojtarit, por mbi të gjitha duke përfshirë edhe reklamën. Është e paimagjinueshme që media elektronike t'i japë hapësira pa fund përtej ligjit pikërisht reklamës së lojërave të fatit dhe nxitjes së qytetarëve për t'u bërë pjesë e këtyre lojërave. Definicionet në ligj në pjesën më të madhe të tyre janë të qarta, ashtu siç ka definicione që kanë nevojë për rregullim. Ligji ndalon ose lejon reklamën në ambientet ku zhvillohen gara sportive, por kur nuk ka prezencë të të rinjve deri në moshën 21 vjeç. Për fat të keq, stadiumet tona, atyre të *foot* këmbës, atyre të *top* këmbës, por edhe atyre me dorë janë të mbushura pikërisht me të rinj.

Në rast se do të shkojmë drejt rishikimit të ligjit, pa asnjë diskutim duhet bërë edhe ajo që unë kërkova, në qoftë se rregullohet me udhëzim, të bëhet për përmasat e këtyre sallave dhe natyrisht edhe ndarja e bizneseve të tyre nga njëri-tjetri, ashtu siç do të preferoja

në mënyrë të qartë që edhe aktivitetet sportive të ndahen njëherë e mirë nga financimi i lojërave të fatit, kryesisht të basteve sportive. Pra, të ndalohet financimi i ekipeve garuese, në të cilën ndodh garë kombëtare ose jo, nga ekipet sportive. Jo para për sportin nga lojërat e fatit. Unë këtë kisha.

Faleminderit!

Pavarësisht qëndrimit të shprehur, ne duhet të votojmë dekretin e Presidentit. Ka vetëm një votim për këtë, ose pranohet ose rrëzohet. Ju ftoj të votoni. Kush është pro dekretit të Presidentit? Nuk ka. Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka.

Dekreti i Presidentit të Republikës rrëzohet dhe u hap rrugë të gjitha masave favorofiskale që ne kemi miratuar për biznesin e vogël, biznesin bujqësor dhe blegtoral, si dhe agroturizmit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA